

# A po zbatohet Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë?

Teuta Zymeri, Nur Çeku  
Shtator 2020



Qendra për studime të avancuara  
Center for advanced studies

## Për Qendrën për Studime të Avancuara FIT

Qendra për Studime të Avancuara FIT (Qendra FIT) është organizatë e pavarur joqeveritare që kontribuon në zhvillimin e një shoqërie demokratike të emancipuar, në të cilën respektohen të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit. Për arritjen e këtij qëllimi Qendra FIT angazhohet në përmirësimin e gjendjes të grupeve më të ndjeshme të shoqërisë, duke bërë hulumtime dhe avokim për ngritjen e vetëdijesimit.



"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit".

Për Qendrën për Studime të Avancuara FIT .....	1
Abstrakt .....	4
Përmbledhje ekzekutive.....	5
Falenderimet tona.....	7
<b>NJOHURITË E TË PUNËSUARVE PËR LIGJIN.....</b>	<b>8</b>
A kanë të punësuarit njohuri për ligjin dhe a janë ata të familjarizuar me sinjalizimin si proces? .....	8
Llojet e sinjalizimit .....	10
A janë në dijeni punëtorët se ku duhet të raportojnë rastet? .....	12
<b>ANGAZHIMI I PUNËDHËNËSVE PËR ZBATIMIN E LIGJIT .....</b>	<b>13</b>
Caktimi i zyrtarit përgjegjës dhe njoftimi i të punësuarve .....	13
Krijimi i procedurave udhëzuese .....	15
Zhvillimi i trajnimeve dhe doracakëve.....	16
Identifikimi i shkeljeve dhe (mos) raportimi i tyre .....	18
<b>A NDIHEN TË MBROJTUR SINJALIZUESIT .....</b>	<b>20</b>
Ruajtja e konfidencialitetit .....	20
Hezitimi dhe frika për të sinjalizuar .....	21
Mbrojtja institucionale e sinjalizuesve.....	23
<b>PËRFUNDIMET.....</b>	<b>25</b>
<b>REKOMANDIMET .....</b>	<b>26</b>
<b>SHTOJCAT:</b>	
1. Paraqitja e detajuar grafike e përgjigjeve të respondenteve .....	27
2. Pyetësi.....	40
<b>REFERENCAT: .....</b>	<b>44</b>

## Abstrakt

Ky raport hulumtues ekzaminon qëndrimet dhe përcëtimet e qytetarëve lidhur me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve në Kosovë. Të dhënat janë marrë duke përdorë një pyetësor i cili është realizuar gjatë muajit gusht 2020. Respondentët të cilët kanë marrë pjesë në këtë pyetësor janë të punësuar dhe studentë. Të gjeturat tregojnë për nivel shumë të ulët të zbatimit të ligjit, njohuri të pakta të qytetarëve lidhur për përmbajtën e tij, hezitim dhe frikë për të sinjalizuar shkeljet e ndryshme. Nga analizimi i të gjeturave, shihet se institucionet publike dhe sektori privat nuk kanë bërë përpjekje të mjaftueshme për zbatimin e ligjit. Për të ndryshuar kjo gjendje në të ardhmen institucionet publike e private, organizatat e shoqërisë civile, mediat, dhe palët e tjera relevante duhet të angazhohen dhe të punojnë me përkushtim për zbatimin e këtij ligji.

**Fjalët kryesore:** *sinjalizimi i shkeljeve, mbrojtja e sinjalizuesve, sektori publik, sektori privat, të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit, mbrojtja e interesit publik.*

## Përmbledhje ekzekutive

### Autor

**Teuta Zymeri**  
Drejtor, Qendra FIT

**Nur Çeku**  
Ekspert i pavarur

Në sektorin publik dhe privat ndodhin veprime apo praktika të dyshimta të cilat janë në kundërshtim me ligjin dhe dëmtojnë interesin publik. Raportimi i këtyre veprimeve është i rëndësishëm për një qeverisje të mirë, sundim të ligjit, ngritje të integritetit institucional dhe mbrojtje të interesit të përgjithshëm. Por, këto veprime shpesh nuk raportohen për arsye të ndryshme, si: (i) mungesa e rregullave ligjore; (ii) mungesa e njohurive për këto rregulla e procedura; (iii) hezitimi për të raportuar nga frika e hakmarrjes ndaj tyre, apo (iv) ndonjë arsye tjetër. Për të ofruar një perspektivë të re në luftimin e këtyre veprimeve dhe për të siguruar mbrojtjen efikase ligjore për personat që raportojnë, shumë vende kanë miratuar ligje të veçanta për këtë fushë.

Kosova ngjashëm me këto vende ka miratuar Ligjin përkatës për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Ligji është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në nëntor 2018 dhe ka hyrë në fuqi në janar 2019.<sup>1</sup> Dispozitat që i referohen sektorit privat në këtë ligj kanë filluar të zbatohen një vit pas hyrjes në fuqi. Qëllimi kryesor i Ligjit është krijimi i bazës ligjore për përcaktimin e procedurave të sinjalizimit në sektorin publik e privat dhe mbrojtja e sinjalizuesve. Ligji gjithashtu përcakton rregullat për sinjalizimin, procedurën e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e institucioneve publike dhe private në lidhje me sinjalizimin.

**6 Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve ka hyrë në fuqi më 3 janar 2019. Disa dispozita që i referohen sektorit privat kanë hyrë në fuqi një vit pas kësaj date.**

Zbatimi i Ligjit pritet të forcojë integritetin dhe llogaridhënien e institucioneve publike dhe të krijojë parakushte që sektori privat të ofrojë shërbime më efikase për qytetarët. Përmes sinjalizimit, të punësuarit mund të luajnë rol aktiv në zbulimin dhe parandalimin e shkeljeve ligjore apo praktikave të dyshimta. Secili person në kontekstin e marrëdhënies se tij të punës në sektorin publik apo privat, para se të sinjalizojë është me rendësi t'i njohë procedurat, që ta ndihmojnë se si mund ta bëjë këtë. Në të njëjtën kohë, është po kaq e rëndësishme që sinjalizuesit të kenë njohuri rreth mbrojtjes që u garantohet me ligj nga çfarëdo veprimi hakmarrës si pasojë e sinjalizimit.

<sup>1</sup>Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22 /18 Dhjetor 2018, Prishtinë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18303>

Ndikimi pozitiv i këtij ligji është zbatimi afirmativ i tij përmes sinjalizimit të shkeljeve dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Për momentin të dhënat nga institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit evidentojnë raste të pakta dhe mospërfillëse të sinjalizimeve. Ligji ka përcaktuar në nivel kombëtar Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK) si organ përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Sipas Nenit 29 të këtij Ligji, AKK bën pranimin dhe evidentimin e raporteve nga institucionet publike, private, dhe rregulloret lidhur me sinjalizimin. Mirëpo, të dhënat e publikuara nga AKK për rastet e evidentuara të sinjalizimit janë aq të pakta sa gati janë mospërfillëse.

**Në raportin e punës së AKK-së për 2019 raportohet se janë paraqitur vetëm pesë raste të sinjalizimit: dy raportime të brendshme dhe tri të jashtme.**

Në raportin e punës së AKK-se për vitin 2019 shihet se vetëm 14 institucione publike kanë raportuar për rastet e sinjalizimit të brendshëm dhe nga këto institucione vetëm një institucion ka paraqitur dy raste të sinjalizimit.<sup>2</sup> Bazuar në të dhënat e AKK-së, gjatë 2019 janë pranuar vetëm 3 raste të sinjalizimit të jashtëm për t'u trajtuar.<sup>3</sup> Këto të dhëna identifikojnë dy elemente sipas të cilave mund të konstatohet niveli i ulët i zbatimit të Ligjit. E para, ka të bëjë me një numër shumë të vogël të institucioneve publike të cilat kanë raportuar, derisa Ligji përcakton se të gjitha institucionet duhet të bëjnë një raportim për sinjalizimin brenda institucionit. Dhe elementi i dytë është niveli shumë ulët i rasteve të paraqitjes së sinjalizimit.

Qendra për studime të avancuara FIT (Qendra FIT), në kuadër të aktiviteteve të saj, është duke u angazhuar për avancimin dhe zbatimin e ligjit për sinjalizuesit dhe përmirësimin e ambientit që personat të cilët sinjalizojnë të ndihen të sigurt. Qendra FIT, gjatë muajit gusht 2020 në kuadër të projektit “*Sinjalizuesit —zëri i shoqërisë sonë*”, ka realizuar një hulumtim për të matur indikatorët rreth zbatimit të ligjit. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të bëhet një evaluim i zbatimit të Ligjit në praktikë në institucionet e sektorit publik e privat. Konkretisht, të pasqyrohen njohuritë e punëtorëve dhe studentëve lidhur me ligjin në fjalë; njohuritë e tyre për mënyrën se si duhet të raportohet një rast konkret; besimin që

<sup>2</sup>Raportin Vjetor i Punës së AKK-së për vitin 2019, fq. 17.

[https://www.akkks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/01.%20Raporti\\_Vjetor\\_i\\_Punes\\_AKK\\_viti\\_2019\\_vjer\\_final\\_Shqip\\_AKK\\_Mars\\_2020.pdf](https://www.akkks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/01.%20Raporti_Vjetor_i_Punes_AKK_viti_2019_vjer_final_Shqip_AKK_Mars_2020.pdf)

<sup>3</sup> Po aty fq. 17.

ata kanë në mbrojtje të identitetit të tyre kur ata raportojnë; si dhe frikën eventuale që ata kanë nëse raportojnë këto raste.

Në kuadër të këtij hulumtimi, Qendra FIT ka anketuar 214 respondentë që punojnë apo studiojnë në sektor publik ose privat. Pyetësi ka përmbajtur pyetje lidhur me njohuritë e punonjësve për ligjin në fuqi, mënyrën se si funksionon sinjalizimi, procedurat raportuese, çka parashihet të raportohet nga sinjalizuesit, perceptimin e respondenteve lidhur me shkeljet eventuale, besimin në sinjalizuesit dhe gatishmërinë e tyre që të bashkëpunojnë. Pyetësi është i bashkangjitur në Shtojcën B.

Në këtë raport prezantohen të gjeturat kryesore të dala nga përgjigjet e respondentëve. Raporti është i ndërtuar duke sistemuar përgjigjet e respondentëve sipas tematikave të njëjta. Kjo me qëllim që të shihet se si është perceptimi dhe njohuritë e respondentëve për përmbajtjen e ligjit, gjendjen aktuale në institucionet ku ata punojnë dhe nëse ata kanë parë apo identifikuar shkelje në 12 muajt e fundit. Gjithashtu, në raport pasqyrohen edhe dallimet në përgjigje mes kategorive të ndryshme të respondentëve.

Në disa nga përgjigjet e respondentëve ka dallime të rëndësishme në mes të grupeve të ndryshme (p.sh. të punësuarve dhe studentëve, apo sektorit publik dhe privat). Prandaj, këto dallime pasqyrohen në raport. Raporti gjithashtu përmban edhe të dhënat statistikore të përgjigjeve të respondentëve përmes figurave të prezantuara. Në pjesën e fundit pasqyrohen përfundimet dhe rekomandimet përkatëse të Qendrës FIT të nxjerra si rezultat i ekzaminimit të përgjigjeve të respondenteve.

#### Falenderimet tona

Ky hulumtim nuk do mund të bëhej pa ndihmën financiare nga donatori. Ambasada Amerikane në Prishtinë ka siguruar mbështetjen financiare për këtë projekt. Megjithatë, mendimet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura këtu janë të autorëve dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.

Qendra FIT, falënderon dhe u është mirënjohës të gjithë personave që treguan gatishmëri për plotësimin e pyetësorit, pa të cilët do të ishte i pamundur realizimi i këtij hulumtimi.

**Qendra FIT  
falënderon  
Ambasadën  
Amerikane për  
mbështetjen  
financiare për  
këtë projekt.**

## 1. NJOHURITË E TË PUNËSUARVE PËR LIGJIN


A kanë të punësuarit njohuri për ligjin dhe a janë ata të familjarizuar me sinjalizimin si proces?

Sinjalizues mund të jetë çdo person fizik i cili në kontekstin e marrëdhënies së tij të punës në një institucion të sektorit publik ose privat, sinjalizon (raporton) shkeljet e ndryshme. Në kontekstin e marrëdhënies së punës përfshihen, jo vetëm të punësuarit aktual por edhe ish të punësuarit, bashkëpunëtorët, vullnetarët, praktikantët, kontraktorët apo nënkontraktorët e shërbimeve.<sup>4</sup> Studentët të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale me universitetet mund të jenë sinjalizues gjithashtu.

Nisur nga fakti se për të raportuar siç është përcaktuar nga Ligji, punëtorët dhe studentët duhet fillimisht të njohin ligjin. Prandaj, në fillim të anketimit ne kemi pyetur respondentët nëse ata *janë personalisht në njohuri për ekzistimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve*.

**Figura 1. A janë punëtorët/studentët të njoftuar me ligjin për sinjalizim?**

58.9 përqind e respondentëve kanë deklaruar se nuk janë në dijeni për ligjin.



Në mesatare, 58.9 përqind e respondentëve kanë deklaruar se nuk janë në dijeni për ligjin në fuqi. Kjo përqindje e mungesës së informacionit për ligjin është më e lartë te studentët krahasuar me

<sup>4</sup>Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 3 (1.5.) [Përkufizimet].




**85.9 përqind e studentëve kanë deklaruar se nuk janë në dijeni për ligjin.**

punëtorët. Rreth 86 përqind e studentëve (Figura 5, Shtojca 1) kanë deklaruar se nuk janë në njohuri për ligjin, derisa 45.5 përqind e të punësuarve kanë deklaruar se kanë njohuri për ligjin.

Mungesa e njohurive për ligjin është në nivel më të lartë edhe tek punëtorët që punojnë në ndërmarrjet e mëdha. Rreth 73 përqind e punëtorëve që punojnë në ndërmarrje të cilat kanë 500 deri 1000 punëtorë kanë deklaruar se nuk janë në dijeni për ligjin. Rreth 65 përqind e punëtorëve që punojnë në ndërmarrje me mbi 1000 punëtorë kanë raportuar se nuk kanë njohuri për ligjin; derisa të punësuarit në sektorin publik kanë më shumë njohuri krahasuar me ata në sektorin privat.

**Figura 2. A janë punëtorët të informuar lidhur me ligjin për sinjalizim**



**73.3 përqind e punëtorëve që punojnë në ndërmarrje të mëdha me 500 deri 1000 punëtorë kanë deklaruar se nuk janë në dijeni për ligjin.**


Në vazhdim, për të vlerësuar qëndrimin lidhur me sinjalizimin si proces, ne kemi pyetur respondentët nëse *ata janë të familjarizuar me përmbajtjen e ligjit dhe sinjalizimin si proces në tërësi?* Përsëri përqindja e atyre që kanë deklaruar se nuk kanë njohuri ka rezultuar të jetë shumë e lartë. Më pak se një-prej-pesë respondenteve ka deklaruar se është i familjarizuar me ligjin për sinjalizim, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe sinjalizimin si proces.

Nga 211 respondentë sa i janë përgjigjur kësaj pyetje, 81 përqind kanë deklaruar se nuk janë të familjarizuar me procedurat e

raportimit. Prej tyre kategoria e studentëve del përsëri të jetë shumë pak e familjarizuar me procesin. Sipas përgjigjeve të studentëve, 91.4 përqind kanë deklaruar se nuk janë në dijeni se çka parasheh ligji dhe si funksionon procesi i raportimit të shkeljeve. Kjo është shqetësuese, sepse mungesa e njohurive për përmbajtjen e ligjit zvogëlon gjasat që ligji të zbatohet në praktikë.

**Figura 3. A janë punëtorët të familjarizuar me ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe sinjalizimin si proces në tërësi?**

81 përqind e respondentëve nuk janë të familjarizuar me ligjin dhe sinjalizimin si proces.



### Llojet e sinjalizimit

Ligji parasheh tri mënyra të raportimit të rasteve: a) sinjalizim i brendshëm i cili bëhet te zyrtari përgjegjës apo tek drejtuesi i institucionit në rast kur mungon zyrtari përgjegjës; b) sinjalizim i jashtëm i cili për sektorin publik behët tek AKK, ndërsa për sektorin privat bëhet te organet rregullatorë<sup>5</sup> dhe c) sinjalizimi publik që mund të bëhet përmes rrjeteve sociale, tubimeve publike, mediave, etj. Për më shumë, sinjalizimi mund të paraqitet me shkrim, me postë, e-mail dhe gojarisht. Gjatë procesit të raportimit është e rëndësishme që me rastin e raportimit të regjistrohen të dhënat kryesore të nevojshme siç janë: (i) data e pranimit të raportimit, (ii) të dhënat e sinjalizuesit, (iii) të dhënat personit(ve)të

<sup>5</sup> Për llojet e sinjalizimit, shqyrtimin e tyre dhe agjencitë rregullatorë shih Nur Çeku (2019) Manual për Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Qendra FIT, <https://fit-ks.org/wp-content/uploads/2020/02/15-Manuali-per-Sinjalizues-FINAL.pdf>.


sinjalizuar, (iv) përmbajtja e shkurtër e informatës dhe (v) faktet (provat), nëse ka të tilla. Qendra FIT në pyetësin e zhvilluar ka pyetur respondentët:

*A jeni në dijeni se në çfarë forme mund ta bëni raportimin?*

**67.8 nuk janë të sigurt ose nuk janë në dijeni se në çfarë forme mund ta bëjnë raportimin.**

Më shumë se gjysma e të anketuarve (67.8përqind) kanë deklaruar se *nuk janë të sigurt* ose *nuk janë në dijeni* se në çfarë forme mund të bëjnë raportimin. Kategoria e të punësuarve dinë më shumë për format e raportimit (62.9 përqind janë) krahasuar me studentët. Studentët në masë të madhe kanë deklaruar se nuk janë në dijeni se në çfarë forme mund ta bëjnë raportimin (77.4 përqind e tyre).

**Figura 4. A janë punëtorët në dijeni se në çfarë forme mund ta bëjnë raportimin?**



**34.1 përqind e respondentëve nuk janë në dijeni me format e raportimit.**


Nuk vërehet ndonjë dallim i rëndësishëm në mes të kategorisë së respondentëve në sektorin publik dhe atë privat. Por vërehet dallim i rëndësishëm nëse institucioni, ndërmarrja apo universiteti ka më shumë apo më pak punëtorë. Ata që punojnë në ndërmarrje të mëdha kanë përqindje më të lartë të deklartimit se *'nuk dinë si të raportojnë'*. Pra, në përgjithësi mund theksohet se qytetarët kanë deklaruar se nuk janë në dijeni në çfarë forme mund ta bëjnë raportimin e shkeljeve potenciale.

### A janë në dijeni punëtorët se ku duhet të raportojnë rastet?

**“Përqindje lartë e respondentëve kanë deklaruar se ata nuk dijnë ku duhet të raportojnë shkeljet.”**

Përveç formave të raportimit, është e rëndësishme që të punësuarit të kenë njohuri se *ku apo te kush* mund ta bëjnë raportimin. Ne kemi pyetur respondentët nëse ata janë në dijeni se ku duhet të bëjnë një veprim të tillë. Përgjigjet e dhëna tregojnë se përveç që ka pak njohuri për format e raportimit, respondentët kanë deklaruar se dijnë shumë pak ku mund ta bëjnë raportimin. Rreth 62 përqind e tyre kanë thënë ‘*nuk janë në dijeni ose nuk janë të sigurt*’ se ku mund të raportojnë një shkelje apo praktikë të dyshimtë.

**Figura 5. A jeni të informuar se ku mund të raportoni një shkelje apo praktikë të dyshimtë**



**“Vetëm 37.4 përqind kanë raportuar se e dijnë ku duhet të raportojnë shkeljet.”**

## 2. ANGAZHIMI I PUNËDHËNËSVE PËR ZBATIMIN E LIGJIT

### Caktimi i zyrtarit përgjegjës dhe njoftimi i të punësuarve


**55.2 përqind kanë raportuar se institucioni i tyre NUK ka caktuar zyrtarin për raportim të shkeljeve.**

Mekanizmi efektiv i raportimit të brendshëm është esencial në procesin e raportimit. Është detyrim ligjor që entitetet të caktojnë zyrtarin përgjegjës, si mekanizëm të brendshëm ku bëhet raportimi. Sipas ligjit, çdo institucion publik në nivel qendror dhe lokal i cili ka autoritet për të ushtruar kompetenca legjislative, administrative, gjyqësore, prokuroriale apo institucion tjetër publik të përcaktuar me ligje të veçanta që ka më shumë se 15 persona të punësuar duhet ta bëjë këtë. Në sektorin privat ky numër është dukshëm më i madh, pasi çdo subjekt privat që ka më shumë se 50 të punësuar duhet ta caktojë zyrtarin përgjegjës si mekanizëm raportimi.<sup>6</sup> Prandaj, një nga pyetjet e drejtuara respondentëve në këtë hulumtim ka qenë:

*A ka caktuar institucioni/ organizata juaj zyrtarin përgjegjës për raportim?*

Më pak se një-në-katër veta ka deklaruar se entiteti legal ku ai punon ose studion ka caktuar personin përgjegjës për raportim.

**Figura 6. Caktimi i zyrtarit përgjegjës për raportim**



**21.9 përqind nuk e dijnë nëse është caktuar zyrtari për raportim të shkeljeve.**

<sup>6</sup> Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 17 [ Obligimet e punëdhënësit].


Nga kategoria e të punësuarve, 22.9 përqind kanë deklaruar se institucioni i tyre ka caktuar zyrtarin përgjegjës dhe përafërsisht po aq kanë deklaruar se *nuk kanë dijeni për caktimin e zyrtarit*. Derisa 55.2 përqind e respondentëve kanë deklaruar se institucioni i tyre NUK ka caktuar zyrtarin përgjegjës.

**98.6 përqind e Studentëve kanë deklaruar se Universiteti i tyre nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për raportim ose ata nuk janë në dijeni.**

Studentët nuk kanë njohuri lidhur me caktimin e personit përgjegjës për sinjalizim. Vetëm 1.4 përqind e tyre kanë deklaruar se Universiteti i tyre ka caktuar zyrtarin përgjegjës. Gjithashtu, punëtorët dhe studentët e sektorit privat kanë përqindje më të lartë të deklarimit “jo nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për raportim, ose jo nuk e dijmë” (83.9 përqind kundrejt 72 përqind). Nga përgjigjet e respondentëve është vërejtur se punëtorët e ndërmarrjeve të mëdha dinë shumë më pak lidhur me caktimin e zyrtarit përgjegjës, krahasuar me ata në ndërmarrje me më pak se 500 punëtorë.

Një pyetje e ndërlidhur për këtë temë në pyetësor ishte *nëse të punësuarit dhe studentët janë në dijeni se cili është personi zyrtar i caktuar për raportim?* Nga përgjigjet e të gjithë respondentëve del se 81.4 përqind kanë deklaruar ‘*nuk e di*’ se cili është personi i caktuar zyrtar. Kurse nga studentët, 98.4 përqind e tyre janë përgjigjur se nuk kanë njohuri se kush është zyrtar përgjegjës i caktuar për raportim (Figura 9, Shtojca 1).

**Figura 7. A e dini ju se kush është zyrtari përgjegjës për raportim**



**81 përqind nuk e dijnë se kush është zyrtari përgjegjës për raportim.**

**88.9 përqind e punëtorëve në sektorin privat nuk e dijnë kush është zyrtari përgjegjës për raportim (figura 8, Shtojca 1).**

Sipas një raporti hulamtues të Lëvizjes FOL, nga rreth 160 institucione publike të kontaktuara nga kjo organizatë, 87 prej tyre kanë deklaruar që e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për trajtimin e sinjalizimit të brendshëm. Në të njëjtin hulumtim jepen të dhëna, që sipas AKK-së, mbi 200 institucione publike kanë përzgjedhur Zyrtarin Përgjegjës<sup>7</sup>. Bazuar në këto të dhëna del se, edhe pse shumë institucione publike kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për trajtimin e sinjalizimeve të brendshme, ato nuk kanë informuar të punësuarit e tyre se cili është ky zyrtar përgjegjës. Kjo mund të jetë edhe si pasojë e moskompletimit të legjisllacionit sekondar për zbatimin e Ligjit, konkretisht Rregullores për shqyrtimin e sinjalizimit të brendshëm.

### Krijimi i procedurave udhëzuese


Për zbatimin e Ligjit, është thelbësore që të punësuarit të kenë njohuri lidhur me procedurat e sinjalizimit. Mekanizmat e raportimit të sinjalizuesve duhet të shoqërohen nga politika efektive të mbrojtjes së sinjalizuesve. Vendosija e një linje telefonike, përmes së cilës punonjësit/studentët mund të raportojë raste të dyshuara është një nga procedurat.

Mirëpo, në përgjithësi ligji përcakton se punëdhënësi ka detyrim që të punësuarve t’iu sigurojë udhëzime me shkrim apo çfarëdo informacioni të dobishëm, i cili ndihmon në lehtësimin e zbatimit të ligjit.<sup>8</sup> Ne kemi pyetur respondentët nëse ata *‘mendojnë se procedurat për raportim/sinjalizim janë mirë të instaluar në institucionin/organizatën e tyre’*. Rezultati i përgjigjeve është në grafikun më poshtë. Qëllimet i këtyre procedurave është që të inkurajohen punonjësit për të raportuar dyshimet për shkelje sa më shpejt të jetë e mundur, me dijeninë që shqetësimet e tyre do të merren seriozisht dhe të hetohen sipas rastit. Në të njëjtën kohë është me rëndësi që të respektohet konfidencialiteti i tyre. Udhëzimet duhet të jenë të qarta për të ngritur shqetësimet e sinqerta “të bëra në interes të publikut” pa frikë nga hakmarrjet, edhe nëse rezultojnë të gabuara.

<sup>7</sup> Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Sfidat e Zbatimit në Praktike Lëvizja FOL, Prishtinë 2020.fq. 3. <https://levizjafol.org/ligji-per-mbrojtjen-e-sinjalizuesve-sfidat-e-zbatimit-ne-praktike/>

<sup>8</sup> Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 28 [Vetëdijesimi i të Punësuarave].

**Figura 8. A mendoni se procedurat për raportim janë mirë të instaluar në institucionin/organizatën tuaj?**



65.7 përqind kanë deklaruar se procedurat për raportim NUK janë të instaluar mirë në institucionin/organizatën e tyre.

Përgjigjet në këtë pyetje nxjerrin në pah se institucionet kanë bërë shumë pak në këtë drejtim. Kështu, 65.7 përqind e të anketuarve kanë deklaruar se nuk janë instaluar siç duhet procedurat për raportim në organizatat apo institucionet ku ata punojnë.


### Zhvillimi i trajnimeve dhe doracakëve

Për të lehtësuar kuptimin e dispozitave ligjore dhe rrjedhimisht zbatimin e tyre, institucionet e sektorit publik dhe organizatat e sektorit privat do të duhej të zhvillojnë trajnime të zyrtarëve përgjegjës por edhe të personelit në përgjithësi. Në lidhje me trajnimet e brendshme rreth sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve përgjigjet e respondentëve tregojnë se ka pasur veprime të pakta nga institucioni/organizata në këtë drejtim. Nga të gjithë respondentët, vetëm 8.5 përqind e tyre kanë deklaruar se ka pasur trajnime, derisa 34.5 përqind kanë deklaruar se *nuk janë mbajtur trajnime të tilla*, 37.0 përqind janë përgjigjur se *nuk kishin njohuri për trajnime*. Sa i përket studentëve, vetëm 2.8 përqind e tyre janë përgjigjur se ka pasur trajnime për sinjalizim, derisa 11.4 përqind e punëtorëve kanë theksuar se kanë pasur trajnime. Përsëri, te ndërmarret e mëdha shifrat janë alarmuese. 95 përqind e të punësuarve në organizata me mbi një mijë punëtorë kanë deklaruar se *nuk ka pasur ose nuk e dijnë se ka pasur trajnime* lidhur me sinjalizimin në institucionin e tyre.

vetëm 8.5 përqind e të anketuarve kanë deklaruar se ka pasur trajnime për sinjalizim”



**Figura 9. A ka mbajtur institucioni/organizata trajnime të brendshme rreth sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve**



Dallimi në këtë aspekt sa i përket sektorit privat dhe publik është shumë i vogël.


Ndërsa, lidhur me zhvillimin e doracakëve, manualeve apo udhëzuesve, si dokumente lehtësuese për zbatimin e ligjit, përgjigjet e respondentëve janë të ndryshme. Njësoj si me trajnime, edhe me zhvillim të doracakëve për raportim, 54 përqind e respondentëve kanë deklaruar se institucioni i tyre nuk ka zhvilluar udhëzues për raportim.

**54.5 përqind kanë deklaruar se institucioni i tyre nuk ka zhvilluar doracak apo procedurë për raportim**

Nga kategoria e të punësuarve 56.4 përqind kanë deklaruar se nuk ka pasur ndonjë dokument të tillë; 25.7 përqind janë përgjigjur pozitivisht; dhe 17.9 përqind janë përgjigjur se nuk e dijnë. Ndërsa, nga kategoria e studentëve 50.7 përqind janë deklaruar se universitetet nuk kanë zhvilluar ndonjë dokument të tillë; derisa 49.3 përqind kanë deklaruar se nuk kanë dijeni për një dokument të tillë.<sup>9</sup>

<sup>9</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit në muajin nëntor 2019, ka shpërndarë tek institucionet publike “Udhëzuesin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, i përgatitur në bashkëpunim me Projektin Kundër Krimin Ekonomik- PECK II. Udhëzuesi në është publikuar në faqet zyrtare të shumë institucioneve publike. Udhëzuesi për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Autor: Wim Vandekerckhove, Ekspert i Këshillit të Evropës gjendet në: <https://rm.coe.int/handbook-on-protection-of-whistleblowers-alb/168097edoc>.

**Figura 10. A ka zhvilluar institucioni/organizata juaj ndonjë udhëzim, doracak, apo procedurë tjetër lidhur me sinjalizimin**



### Identifikimi i shkeljeve dhe (mos) raportimi i tyre

Ligji përcakton kategoritë e shkeljeve për të cilat mund të raportohet/sinjalizohet. Në këto shkelje bëjnë pjesë: mos përmbushja e detyrimeve ligjore, keqadministrimi i drejtësisë, dëmtimi i ambientit, keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe parasë publike, rreziku ndaj shëndetit, keqmenaxhimi i institucionit dhe veprimet tjera diskriminuese. Këto fusha janë të integruara sepse brenda tyre mund të ketë shumë veprime të tjera apo praktika të dyshimta të cilat mund të kualifikohen si shkelje sipas këtij ligji.

**6** një në tre persona ka raportuar se ka vërejtur shkelje që janë për tu raportuar.


Ligji u referohet “shkeljeve” në mënyrë të përgjithësuar për arsye se sinjalizimet në fakt janë dyshime, prandaj ligji përdorë termin “besim i arsyeshëm” e jo “dyshim i bazuar mirë”. Termi “besim i arsyeshëm” nënkupton që sinjalizuesi në momentin e sinjalizimit beson me vetëdije se ekziston kërcënimi apo cenimi i interesit publik. Edhe në rast se kërcënimi apo cenimi i interesit publik nuk është materializuar, prapëseprapë sinjalizimi është veprimi i duhur. Mosmaterializmi është situata kur shkelja apo praktika dyshuese e sinjalizuar nuk ka ndodhur, nuk është duke ndodhur, nuk do të ndodhë realisht dhe nuk ka cenim të interesit publik.

Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar dhe nuk ka detyrim të mbledhë apo sigurojë prova.<sup>10</sup>

**29.1 përqind kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit kanë vërejtur shkeljeqë janë për tu raportuar**

Prandaj, për shkak të rëndësisë që paraqet identifikimi dhe raportimi i shkeljeve njëra prej pyetjeve ka qenë *”nëse në 12 muajt e fundit ka pasur shkelje të tilla në institucionin/organizatën tuaj”*. Rreth 29.1 përqind e respondentëve kanë deklaruar se në 12 muajt e kaluar kanë vënë re shkelje të ndryshme (figura 11) . Rreth 24 përqind nga kategoria e të punësuarve kanë deklaruar se në 12 muajt e kaluar kanë vënë re shkelje të ndryshme, ndërsa 40.9 përqind e studentëve respondentë kanë deklaruar gjithashtu se janë vërejtur apo identifikuar veprime dhe praktika të cilat përkojnë me shkeljet e listuara sipas Ligjit (Figura 21, Shtojca 1).

**Figura 11: A keni vërejtur shkelje në 12 MUAJT e fundit në institucionin/ organizatën tuaj?**



**shkeljet janë dukshëm më të larta në sektorin publik dhe tek universitetet (figura 21 dhe figura 22).**

<sup>10</sup> Nur Çeku (2020) Doracak për Sinjalizuesit, Lëvizja FOL, Prishtinë fq. 11.  
<https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2020/07/Doracak-per-sinjalizuesit.pdf>.

### 3. A NDIHEN TË MBROJTUR SINJALIZUESIT

#### Ruajtja e konfidencialitetit

Mbrojtja e sinjalizuesve është esenciale për të promovuar transparencë, integritet dhe zbulim të sjelljeve të pahijshme në vendin e punës. Mbrojtja e sinjalizuesit dhe konfidencialiti i tij është thelbi i ligjit. Parimi i konfidencialiteti është parim kyç në procedurën e trajtimit të sinjalizimit. Zyrtari përgjegjës në çdo kohë ruan konfidencialitetin e informacionit të raportuar duke mos e transmetuar te personat e tretë brenda apo jashtë institucionit. Individët për të sinjalizuar duhet të besojnë se parimi i konfidencialitetit do të zbatohet.

Mbrojtja e sinjalizuesve është esenciale për të promovuar transparencë, integritet dhe zbulim të sjelljeve të pahijshme në vendin e punës. Institucionet që kanë kulturë të punës të hapur dhe efektive promovojnë transparencë dhe dialog që mund të ndihmojë në adresimin e këtyre shqetësimeve. Ato mund të bëjnë ndryshimin që një punonjës të flasë ose të heshtë. Në disa shtete, për ta lehtësuar sinjalizimin në sektorin publik, kanë miratuar masa stimuluese, përfshirë shpërblimet monetare ose kompensimin, dhe disa mekanizma të tjerë përcjellës.<sup>11</sup> Shumë vende gjithashtu aplikojnë ndëshkime në rast të vërtetimit të hakmarrjes ndaj sinjalizuesve.


**6 40 përqind nuk besojnë në ruajtjen e konfidencialitetit gjatë raportimit.**

Qendra FIT ka pyetur respondentët se *a ndihen të sigurt dhe a besojnë në ruajtjen e konfidencialitetit*. Përgjigjet e respondentëve janë se 40 përqind nuk besojnë në ruajtjen e konfidencialitetit; 34 përqind kanë deklaruar se nuk kanë përgjigje dhe vetëm 24 përqind besojnë në ruajtjen e konfidencialitetit. Një rezultat i tillë tregon se ekziston një mosbesueshmëri që procedurat do të garantojnë konfidencialitet në rastet e tilla. Nëse besimi është i ulët, atëherë edhe gjasat për raportim janë të ulëta e me këtë edhe zbatimi i ligjit nuk është duke ndodhur.

<sup>11</sup> Për kompensimin e sinjalizuesve shih "Sinjalizimi dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve" Instituti i Kosovës për Drejtësi, Dhjetor, 2019, Prishtinë, fq. 11. <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/12/FINAL-Sinjalizuesit-dhe-mbrojtja-e-sinjalizuesve-ne-Kosove.pdf/>

**Figura 12. A besoni se raportimi mbahet konfidencial**

besimi më i ulët është tek punëtorët e sektorit publik dhe tek studentët (figura 19 dhe figura 20, shtojca 1).



Në sektorin publik, shkalla e mosbesimit se raportimi mbahet konfidencial është 46 përqind, kurse respondentët që punojnë në ndërmarrjet me mbi 1000 punëtorë, 58 përqind e tyre kanë deklaruar se nuk besojnë se raportimi mbahet konfidencial (Figura 19, Shtojca 1).


### Hezitimi dhe frika për të sinjalizuar

Sinjalizuesi mbrohet nga çdo veprim i dëmshëm i cili mund të ndërmerret kundër tij nga punëdhënësi për shkak të sinjalizimit. Ligji përcakton se personi që sinjalizon mbrohet, përfshirë veprimet si: shkarkimi nga puna; pezullimi; ulja në pozitë; humbja e statusit dhe privilegjeve; zvogëlimi pagës; vlerësimi negativ; përfundimi i një kontrate për mallra apo shërbime; veprime të tjera të dëmshme.<sup>12</sup> Pavarësisht garancive ligjore, 46 përqind e respondenteve kanë deklaruar se kanë frikë të raportojnë. Kjo sigurisht ka të bëjë edhe me punën dhe funksionimin e sundimit të ligjit, në përgjithësi besimin në institucione.

<sup>12</sup> Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 22 [ Mbrojtja nga veprimet e dëmshme]


**Figura 13. Nëse lajmëroni një sjellje jo të mirë a keni frikë se mund të identifikoheni, largoheni nga puna apo vini në rrezik veten dhe familjen tuaj.**

46 përqind e respondentëve kanë raportuar se kanë frikë se mund të identifikohen, largohen nga puna, dhe se do ta vinin veten dhe familjen në rrezik nëse raportojnë.



Hezitimi dhe frika e hakmarrjes është më e lartë tek respondentët që janë studentë. Kështu, 58.6 përqind e studentëve kanë frikë të raportojnë derisa kjo përqindje tek punëtorët është më e ulët (39.9 përqind).

**Figura 14: Nëse lajmëroni një sjellje jo të mirë a keni frikë se mund të identifikoheni, largoheni nga puna, apo të vini në rrezik veten dhe familjen tuaj?**



Qëllimi i ligjit për sinjalizuesit është që të mbrojnë individët nga ekspozimi dhe hakmarrja për zbulimin e sjelljeve të këqija. Megjithatë, nga rezultatet e marra përmes kësaj ankete duket se punëtorët kanë besim të ulët dhe frikë që të raportojnë. Si rezultat, mund të vijnë veprime hakmarrëse dhe diskriminuese. Shumica e vendeve perëndimore sigurojnë mbrojtje nga një gamë e gjerë e hakmarrjeve dhe shpesh zbatojnë masa disiplinore si një sanksion dhe rivendosje në punë si një siguri nga hakmarrja.

### Mbrojtja institucionale e sinjalizuesve

Fryma e Ligjit është që sinjalizimi së pari të raportohet brenda institucionit/ organizatës përkatëse. Nëse dikush bën një raport të brendshëm, kjo tregon se ata ende kanë besim tek institucioni. Nëse institucioni nuk përgjigjet në mënyrë të drejtë dhe profesionale, personi do të humbasë besimin tek institucioni dhe mund të raportojë jashtë institucionit në një agjenci qeveritare ose në media.<sup>13</sup>


Qendra FIT ka pyetur respondentët *nëse institucioni/ organizata juaj ka bërë përpjekje serioze për të mbrojtur sinjalizuesit kur ata ngrisin shqetësime*. Vetëm 17 përqind kanë deklaruar se institucioni i tyre ka bërë përpjekje të mjaftueshme, derisa 52 përqind kanë deklaruar *'nuk e di'* e 18 përqind kanë deklaruar se *'nuk është bërë përpjekje e rëndësishme'* që të mbrohen sinjalizuesit.

Në këto përgjigje nuk ka dallime të rëndësishme sa i përket grupeve të respondentëve (punëtor apo student; ndërmarrje e vogël apo e madhe; sektor publik apo privat). Pra, të gjithë në përgjithësi kanë përceptim përafërsisht të njëjtë se institucionet, ndërmarrjet dhe universitetet kanë bërë pak përpjekje për të mbrojtur sinjalizuesit nëse ata raportojnë shkelje të ndryshme.

---

<sup>13</sup>Udhëzuesin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve-PECK, fq.20.

**Figura 15. A mendoni se institucioni/organizata juaj ka bërë përpjekje të rëndësishme që të mbrojë sinjalizuesit kur ata kanë ngritur shqetësimet e tyre**





#### 4. PËRFUNDIMET

Nga përgjigjet e analizuara të respondentëve, Qendra FIT ka nxjerrë këto përfundime:

- i. Ligji për sinjalizuesit nuk po zbatohet sepse institucionet e sektorit publik dhe sektorit privat nuk janë duke bërë përpjekje të mjaftueshme për të zbatuar ligjin. Nuk kanë instaluar procedurat e përshtatshme për sinjalizimin; nuk kanë zhvilluar trajnime e dokumente udhëzuese; dhe nuk kanë njoftuar personelin e tyre lidhur me caktimin e zyrtarëve përgjegjës.
- ii. Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve në Kosovë është shumë i kufizuar dhe pa efekt.
- iii. Mosmiratimi i deritanishëm i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit, përbën një dështim serioz të institucioneve përgjegjëse.
- iv. Shumica e institucioneve publike nuk kanë zbatuar llogaridhënien për të paraqitur raport vjetor lidhur me rastet e sinjalizimit të brendshëm në AKK për periudhën raportuese 2019.
- v. Procedura e sinjalizimit të jashtëm për sektorin privat, tek i cili përcaktohet të bëhet organi rregullator për këtë sektor, nuk është shumë e qartë për të punësuarit në këtë sektor.
- vi. Niveli i njohurive për Ligjin është shumë i ulët në kategoritë e ndryshme, por me theks të veçantë rezulton i ultë në kategorinë e studentëve.
- vii. Kategoritë e të punësuarve dhe studentëve nuk ndihen të sigurt dhe kanë frikë të raportojnë. Ata nuk besojnë se raportimi i tyre mbahet konfidencial.

## 5. REKOMANDIMET

Me qëllim të zbatimit efikas të ligjit janë të domosdoshme marrja e veprimeve si një vijim:

- a. Qeveria, sipas propozimit të Ministrisë së Drejtësisë, të miratojë aktin nënligjor që përcakton procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit.
- b. Institucionet e sektorit publik dhe privat duhet të njoftojnë të punësuarit e tyre me ekzistimin e ligjit dhe të krijojnë procedura të përshtatshme lidhur me zbatimin e Ligjit.
- c. Institucionet e sektorit publik dhe ato subjektet private duhet të njoftojnë të punësuarit e tyre se kush është zyrtari përgjegjës i caktuar për trajtimin e sinjalizimit.
- d. Organizimi i trajnimeve për zyrtarët përgjegjës dhe të gjithë të punësuarit duhet të konsiderohet në mënyrë që të ngritët niveli i njohurisë për ligjin dhe mënyrën e raportimit.
- e. Organizatat mbikëqyrëse si AKK; Inspektorati i Punës dhe Agjencitë Rregullatorë nevojitet të kenë prioritet monitorimin e zbatimit të këtij Ligji.
- f. Avokimi nga organizatat e shoqërisë civile dhe mediat është pa dyshim thelbësor në ngritjen e vetëdijes qytetare për të sinjalizuar shkeljet e ndryshme që cenojnë interesin publik. Rrjetëzimi dhe organizmi i platformave të përbashkëta mes OJQ-ve, duke integruar përvojat e tyre do ta fuqizojë rolin e tyre për zbatimin e Ligjit.

## SHTOJÇË: 1. Paraqitja e detajuar grafike e përgjigjeve të respondentëve

Figura 1. A jeni i punësuar apo student?




Figura 2. Nëse jeni i punësuar, a punoni/studioni në sektorin publik apo privat?




Figura 3. Sipas njohurive tuaja, sa punëtorë përafërsisht ka institucioni/organizata juaj?




Figura 4. Sipas njohurive tuaja, sa punëtorë përafërsisht ka institucioni/organizata juaj?  
(ndarë sipas grupeve punëtorë dhe studentë)




Figura 5. Ju personalisht, a jeni në dijeni për Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve?




Figura 6. Ju personalisht, a jeni në dijeni për Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve? (sipas sektorëve)




Figura 7. A e ka caktuar institucioni/organizata juaj Zyrtarin Përgjegjës për Sinjalizim?




Figura 8. A e ka caktuar institucioni/organizata juaj Zyrtarin Përgjegjës për Sinjalizim?




Figura 9. Nëse po, a e dini ju se kush është ky Zyrtar Përgjegjës?




Figura 10. A jeni i informuar se ku mund të raportoni një shkelje apo praktikë të dyshimtë?




Figura 11. A jeni i informuar se ku mund të raportoni një shkelje apo praktikë të dyshimtë?  
(sipas sektorëve)




Figura 12. A ka zhvilluar institucioni/organizata juaj ndonjë udhëzim, doracak apo procedurë tjetër në lidhje me sinjalizimin, mënyrat e raportimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve?






Figura13. A ka zhvilluar institucioni/organizata juaj ndonjë udhëzim, doracak apo procedurë tjetër në lidhje me sinjalizimin, mënyrat e raportimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve? Sipas grupeve punëtorë e studentë.




Figura 14. A ka zhvilluar institucioni/organizata juaj ndonjë udhëzim, doracak apo procedurë tjetër në lidhje me sinjalizimin, mënyrat e raportimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve?




Figura 15. A jeni i familjarizuar me legjislacionin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe sinjalizimin si proces në tërësi?




Figura 16. A jeni i familjarizuar me legjislacionin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe sinjalizimin si proces në tërësi? (sipas sektorëve publikë e privatë)




Figura 17. A mendoni se procedurat për raportim/sinjalizim janë mirë të instaluar në institucionin/organizatën tuaj?




Figura 18. A mendoni se procedurat për raportim/sinjalizim janë mirë të instaluar në institucionin/organizatën tuaj? (sipas punëtoreve dhe studentëve)




Figura 19. A besoni se raportimi mbahet konfidencial?




Figura 20. A besoni se raportimi mbahet konfidencial? (sipas grupeve)




Figura 21. Nëse lajmëroni një sjellje jo të mirë, a keni frikë se mund të identifikoheni, largoheni nga puna, vini veten dhe familje në rrezik, etj?





Figura 22. Nëse lajmëroni një sjellje jo të mirë, a keni frikë se mund të identifikoheni, largoheni nga puna, vini veten dhe familje në rrezik, etj? (sipas sektorëve)



**JU LUTEM LEXOJENI:** Në 12 muajt e kaluar, ju mund të keni vënë re shkelje të ndryshme, si veprime diskriminuuese, menaxhim të keq të institucionit, mos përmbushje të detyrimeve ligjore, keqpërdorim të parave, rrezik ndaj shëndetit e sigurisë së punëtorëve, etj. Shpeshherë, këto shkelje janë për t'u raportuar. Ju ndoshta NUK keni vërejtur diçka të këtillë, ose KENI vërejtur diçka të këtillë.

Figura 23. A keni vërejtur DIÇKA të ngjashme në 12 MUAJT e fundit në institucionin/ organizatën tuaj?




Figura 24. A keni vërejtur DIÇKA të ngjashme në 12 MUAJT e fundit në institucionin/ organizatën tuaj? (Sipas grupeve punëtorë e studentë)




Figura 25. A mendoni se institucioni/organizata juaj ka bërë përpjekje të rëndësishme që të mbrojë sinjalizuesit kur ata kanë ngritur shqetësimet e tyre.





Figura 26. A mendoni se institucioni/organizata juaj ka bërë përpjekje të rëndësishme që të mbrojë sinjalizuesit kur ata kanë ngritur shqetësimet e tyre. (sipas sektorëve)



SHTOJCË: 2Pyetëtori



Ref:

## PYETËSOR

### LIDHUR ME LIGJIN PËR SINJALIZIMIN DHE ZBATIMIN E TIJ

#### JU LUTEM SË PARI LEXONI KËTË PJESE:

**Qendra për studime të avancuara FIT**- është OJQ me seli në Prishtinë e themeluar ne vitin 2011, me vizionin që të ndihmojë në përmirësimin e gjendjes ekonomike, sociale, kushteve të jetës dhe ngritjen e standardeve politike e ekonomike në vend. FIT aktualisht është duke realizuar një hulumtim në kuadër të projektit “Sinjalizuesit – zëri i shoqërisë sonë”, nën mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

**Qëllimi i hulumtimit** - është që të gjejmë në përgjithësi se sa janë punonjësit të informuar lidhur me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe zbatimin në praktikë të këtij Ligji. Pyetëtori përmban pyetje lidhur me njohuritë e punonjësve për ligjin në fuqi, mënyrën se si funksionon sinjalizimi, procedurat raportuese, çka parashihet të raportohet nga sinjalizuesit, perceptimin e respondentëve lidhur me shkeljet eventuale, besimin në sinjalizuesit dhe gatishmërinë e tyre që të bashkëpunojnë.

**Sfondi**– Sinjalizimi është *raportimi* i veprimeve që konsiderohen joligjore brenda një organizate. Në Kosovë ekziston një perceptim se ka shkelje të shumta dhe praktika jo të mira të cilat dëmtojnë interesin publik por që nuk raportohen. Për të stimuluar procesin e raportimit, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve që raportojnë këto dukuri negative. Ky Ligj përcakton rregullat dhe procedurën e sinjalizimit, të drejtat e mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe detyrimet e institucioneve publike e subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.

**Besueshmëra**- Ky pyetësor është konfidencial dhe anonim. Asnjë informatë NUK do ta lejojë mundësinë e identifikimit të personit që e ka plotësuar dhe nuk do të kalohet te ndonjë palë tjetër.

**Faleminderit**- për bashkëpunimin tuaj në kompletimin e këtij pyetëtori!



## PYETJET

1. A jeni i punësuar? Po  Jo
2. Nëse jeni i punësuar, a punoni në sektorin publik apo privat?  
Publik   
Privat
3. Sipas njohurive tuaja, sa punëtorë përafërsisht ka institucioni/organizata juaj?
4. Ju personalisht, a jeni në dijeni për Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve?  
Po  Jo
5. A ka mbajtur institucioni/organizata juaj trajnime të brendshme për stafin në lidhje me sinjalizimin, mënyrat e raportimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve?  
Po  Jo  Nuk e di
6. A ka zhvilluar institucioni/organizata juaj ndonjë udhëzim, doracak apo procedurë tjetër në lidhje me sinjalizimin, mënyrat e raportimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve?  
Po  Jo  Nuk e di
7. A jeni i informuar se ku mund të raportoni një shkelje apo praktikë të dyshimtë?  
Po  Jo

8. A ka caktuar institucioni/organizata juaj Zyrtarin Përgjegjës për Sinjalizim?

Po  Jo

9. Nëse po, a e dini ju se kush është ky Zyrtar Përgjegjës?

Po  Jo

10. A jeni në dijeni se në çfarë forme mund ta bëni raportimin?

Po jam në dijeni   
Nuk jam i sigurt   
Jo, nuk jam në dijeni   
S'kam përgjigje

11. A jeni i familjarizuar me legjislacionin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe sinjalizimin si proces në tërësi?

Po  Jo

12. A mendoni se procedurat për raportim/sinjalizim janë mirë të instaluar në institucionin/organizatën tuaj?

Po  Jo

13. A besoni se raportimi mbahet konfidencial?

Po   
Jo   
S'kam përgjigje

14. Nëse lajmëroni një sjellje jo të mirë, a keni frikë se mund të identifikoheni, largoheni nga puna, vini veten dhe familje në rrezik, etj?

Po Jo S'kam përgjigje 

**JU LUTEM LEXOJENI:** Në 12 muajt e kaluar, ju mund të keni vënë re shkelje të ndryshme, si veprime diskriminuese, menaxhim të keq të institucionit, mos përmbushje të detyrimeve ligjore, keqpërdorim të parave, rrezik ndaj shëndetit e sigurisë së punëtorëve, etj. Shpeshherë, këto shkelje janë për t'u raportuar. Ju ndoshta NUK keni vërejtur diçka të këtillë, ose KENI vërejtur diçka të këtillë.

15. A keni vërejtur DIÇKA të ngjashme në 12 MUAJT e fundit në institucionin/ organizatën tuaj?

Po Jo Nuk e di Nuk dua të përgjigjem 

16. A mendoni se institucioni/organizata juaj ka bërë përpjekje të rëndësishme që t'i mbrojë sinjalizuesit kur ata kanë ngritur shqetësimet e tyre.

Po Jo Nuk e di Nuk dua të përgjigjem 

Faleminderit që keni marrë pjesë ta kompletioni këtë pyetësor.

## REFERENCAT:

- Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22 /18 Dhjetor 2018, Prishtinë.
- **Raportin Vjetor i Punës se AKK-së për vitin 2019.**[https://www.akkks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/01.%20Raporti\\_Vjetor\\_i\\_Punes\\_AKK\\_viti\\_2019\\_ver\\_final\\_Shqip\\_AKK\\_Mars\\_2020.pdf](https://www.akkks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/01.%20Raporti_Vjetor_i_Punes_AKK_viti_2019_ver_final_Shqip_AKK_Mars_2020.pdf)
- Nur Çeku (2019) Manual për Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Qendra FIT, <https://fit-ks.org/ep-content/uploads/2020/02/15-Manuali-per-Sinjalizues-FINAL.pdf>.
- Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Sfidat e Zbatimit në Praktike Lëvizja FOL, Prishtinë 2020.<https://levizjafol.org/ligji-per-mbrojtjen-e-sinjalizuesve-sfidat-e-zbatimit-ne-praktike/>.
- "Sinjalizimi dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve" Instituti i Kosovës për Drejtësi, Dhjetor, 2019, Prishtinë, <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/12/FINAL-Sinjalizuesit-dhe-mbrojtja-e-sinjalizuesve-ne-Kosove.pdf/>
- Ëim Vandekerckhove (2019) Udhëzues për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Këshilli i Evropës. <https://rm.coe.int/handbook-on-protection-of-whistleblowers-alb/168097ed0c>.
- Nur Çeku (2020) Doracak për Sinjalizuesit, Lëvizja FOL, Prishtinë. <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2020/07/Doracak-per-sinjalizuesit.pdf>.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

323.342.7(496.51)(047)

Zymeri, Teuta

A po zbatohet Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë ? / Teuta Zymeri, Nur Çeku. - Prishtinë : Qendra për Studime të Avancuara FIT, 2020. – 44 f. : ilstr. ; 21 cm.

1. Çeku, , Nur

**ISBN 978-9951-691-04-8**

